



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



12 Nr. 432- 73846, dt. 30.12.2019

Duke u bazuar në nenin 11,12,dhe 40,të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-40,nenit 34, pika 34.6, të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: Që në vështirim të nenit 40 pika 40.2 nën 1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, si dhe në bazë të vendimit të ligjshmërisë nga MAPL-së Nr. IV-020-1208/3 të datës 13.12.2019, për vendimin për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të Pronës Komunal nga Komuna e Drenasit, për ndërtimin e objektit, për nevoja të komunitetit në fshatin Komoran, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të rregullt më datën 27.12.2019, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS KOMUNALE TË DRENASIT PËR NEVOJA TË KOMUNITETIT TË FSHATIT KOMORAN

Neni 1

Të shfuqizohet Vendimi i Kuvendit të Komunës 12 Nr. 351-68571 të datës 29.11.2019, me të cilin vendim ju është dhënë prona komunale në shfrytëzim me afat të gjatë, për ndërtimin e objektit për nevoja të komunitetit të fshatit Komoran, në zonën kad. Komoran në P-320-1.

Neni 2

Pas shfuqizimit të këtij vendimi duke u bazuar në konfirmimin ligjor të MAPL-së në Prishtinë, obligohet Drejtorati për Kadaster, Gjeodezi dhe Pronë që të njoftojë komunitetin e fshatit Komoran.

Neni 3


Për shfuqizimin e këtij vendimi kujdeset, Kryetari i Komunës,dhe Drejtoratet përkatëse të Komunës së Drenasit.

Neni 4.

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe 7, ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit .


Kryetari i Kuvendit të Komunës
Halil Halilaj



Republika e Kosovës


Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration



Për:	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogocit Labinot Halilaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Adrijana Hodžić, Ministre e MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 09.01.2020 Nr.020-1208/11
Zyrtaret përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	
Lënda:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Vjosa Ahmetaj, Zyrtare për monitorim të komunave	
Lloji i aktit:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glllogocit ☐ Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim 12 Nr. 432-73876 për shfuqizimin e vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale të Glllogocit për nevoja të komunitetit të fshatit Komoran
I miratuar më datë: 27.12.2019
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 31.12.2019

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



12 Nr. 432-73868, dt. 30.12.2019

Duke u bazuar në nenin 11,12,dhe 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-40, nenit 34. pika 34.6, të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: Që në vështrim të nenit 40 pika 40.2 nën l të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, si dhe në bazë të vendimit të ligjshmërisë nga MAPL-së Nr. IV-020-1208/4 të datës 17.12.2019, për vendimin për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të Pronës Komunal nga Komuna e Drenasit, për ndërtimin e objektit, për nevoja të komunitetit në fshatin Sankoc, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të rregullt më datë, **27.12.2019**, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS KOMUNALE TË DRENASIT PËR NEVOJA TË KOMUNITETIT TË FSHATIT SANKOC

Neni 1

Të shfuqizohet Vendimi i Kuvendit të Komunës 12 Nr. 351-68575 të datës 29.11.2019, me të cilin vendim ju është dhënë prona komunale në shfrytëzim me afat të gjatë, për ndërtimin e objektit për nevoja të komunitetit të fshatit Sankoc, në zonën kadastrave Sankoc në P-83/1.

Neni 2

Pas shfuqizimit të këtij vendimi duke u bazuar në konfirmimin ligjor të MAPL-së në Prishtinë, obligohet Drejtorati për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë që të njoftojë komunitetin e fshatit Komoran.

Neni 3.

Për shfuqizimin e këtij vendimi kujdeset, Kryetari i Komunës,dhe Drejtoratet përkatëse të Komunës së Drenasit.


Neni 4.

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe 7, ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit .

Kryetari i Kuvendit të Komunës
Abdhot Halilaj



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për:	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogocit Labinot Halilaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit	
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Adrijana Hodžić, Ministre e MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 09.01.2020 Nr.020- 1208/10
Zyrtaret përgjegjës:		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Vjosa Ahmetaj, Zyrtare për monitorim të komunave	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glllogocit	
Lloji i aktit:	□ Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim 12 Nr. 432-73868 për shfuqizimin e vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale të Glllogocit për nevoja të komunitetit të fshatit Sankoc
I miratuar më datë: 27.12.2019
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 31.12.2019

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



Nr. 12-030-7389, dt. 30/12.2019

Duke u bazuar në nenin 11,12,dhe 40, të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34. pika 34.6, të Statutit të Komunës së Drenasit, Kapitulli III, pika 1,2,3 dhe 4, si dhe Kapitulli IV Neni 27 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 4 paragrafi 1 pika 1.1 dhe paragrafi 2 pika 2.3 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme (Ligji Nr. 03/L-139),Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datën, 27.12.2019, miratoi këtë:

V E N D I M

Për shpalljen e Interesit të Përgjithshëm Publik të pjesëve të ngastrave kadastrale, nëpër të cilat do të kalon rruga “Adem Jashari” e cila fillon nga Feronikeli nëpër Poklek, Korroticë e Ultë e deri në Korroticë të Epërme (te Kroj i Mbretit)

Neni 1

Të APROVOHET Propozim vendimi për Shpalljen e Interesit të Përgjithshëm Publik për pjesët e ngastrave kadastrale në:

- Zonën Kadastrale Poklek në sipërfaqe prej S=7.43.64 ha
- Zonën Kadastrale Korroticë e Ultë në sipërfaqe prej S=1.11.77 ha
- Zonën Kadastrale Korroticë e Epërme në sipërfaqe prej S=4.51.25 ha

Shpallja e këtyre parcelave në interes të përgjithshëm është bërë me qëllim të realizimit të interesit publik të Komunës së Drenasit për projektin e ndërtimit-asfaltimit të rrugës tranzitore “Adem Jashari”, e cila lidhë Komunën e Drenasit me autostradën Ibrahim Rugova te rreth rrotullimi te Kroj i Mbretit në Korroticë të Epërme të Komunës së Drenas-it.

Neni 2

Të SHPALLËT Interes i Përgjithshëm Publik kjo paluajtshmëri e cila gjendet në territorin e Komunës së Drenasit gjegjësisht në Zonat Kadastrale në:

- Zonën Kadastrale Poklek në sipërfaqe prej S=7.43.64 ha
- Zonën Kadastrale Korroticë e Ultë në sipërfaqe prej S=1.11.77 ha
- Zonën Kadastrale Korroticë e Epërme në sipërfaqe prej S=4.51.25 ha

Neni 3

Për zbatimin e këtij propozim Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Drenasit i cili do të inicion procedurën e mëtejme për shpronësim të pjesëve të

ngastrave kadastrale në Zonat Kadastrale - Poklek- Korroticë e Ultë - Korroticë e Epërme, me sipërfaqe.

-Zonën Kadastrale Poklek në sipërfaqe prej S=7.43.64 ha

-Zonën Kadastrale Korroticë e Ultë në sipërfaqe prej S=1.11.77 ha

-Zonën Kadastrale Korroticë e Epërme në sipërfaqe prej S=4.51.25 ha

Neni 4

Obligohet Drejtorati për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, që të përfundoj të gjitha procedurat e nevojshme gjeodozike, kadastrale që nevojiten për shpronësimin e këtyre parcelave, duke u bazuar në vendimin nr.01/351-6653 të datës 04.05.2012, të Komisionit Profesional për hartimin e elaboratit Kadastral-Gjeodezik për identifikimin e palujtshmërive që do të shpallen në Interes Publik, e të cilat do të shpronësohen për realizimin e Projektit të rrugës transitore Kroi i Mbretit-Drenas në gjatësi prej 5.5 km.

Neni 5


Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset, Kryetari i Komunës, dhe Drejtoratet përkatëse të Komunës së Drenasit.

Neni 6


Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit .



Kryetari i Komunës
Abinot Halilaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogocit Labino Halilaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit	
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Adrijana Hodžić, Ministre e MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 13.01.2020 Nr.020-1314
Zyrtaret përgjegjës:		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Vjosa Ahmetaj, Zyrtare për monitorim të komunave	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glllogocit	
Lloji i aktit:	☐ Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr. 12-030-73859 për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të pjesëve të ngastrave kadastrale, nëpër të cilat kalon rruga "Adem Jashari" e cila fillon nga Feronikeli nëpër Poklek, Korroticë e Ultë e deri në Korroticë të Epërme (të Kroi i Mbretit)
I miratuar më datë: 27.12.2019
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 31.12.2019

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



12 Nr. 020-7362 dt. 30.12 .2019

Në bazë të nenit 11, 12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 ("Gaz. Zyrt. e Republikës së Kosovës"), nenit 4, 7, 8, 9 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2016 për Procedurat e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, si dhe nenit 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë 27.12.2019, miratoi këtë:

V E N D I M

Për formimin e Komitetit Konsultativ Komunal për Barazi Gjinore.

Neni 1

Më këtë Vendim Kuvendi i Komunës aprovoi listën e anëtarëve të Komitetit Konsultativ Komunal për Barazi Gjinore e propozuar nga komisioni përzgjedhës në përbërje prej pesë (5) anëtarëve.

Neni 2

Aprovohet lista e anëtareve të Komitetit të Konsultativ Komunal për Barazi Gjinore në përbërje prej pesë (5) anëtarëve si vijon:

1. Halide Morina
2. Besarta Demaku
3. Arton Hasani
4. Elira Tafilaj Nebihi
5. Valmir Nishori

Neni 3

Mandati i komitetit konsultativ nga themelimi dhe aprovimi në Kuvend është 4 vjeçar.

Neni 4


Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Informimit;
- Zyrës së Kuvendit;
- Zyra e Personelit
- Arkivit;



[Signature]
Labinot Halilaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogocit Labintot Halilaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Adrijana Hodžić, Ministre e MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 09.01.2020 Nr.020-1316
Zyrtaret përgjegjës:		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Vjosa Ahmetaj, Zyrtare për monitorim të komunave	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glllogocit	
Lloji i aktit:	☐ Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim 12 Nr. 020 - 73623 për formimin e Komitetit Konsultativ Komunal për Barazi Gjinore
I miratuar më datë: 27.12.2019
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 31.12.2019

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.